

KOMPANIA RAJONALE UJËSJELLË “ MITROVICA” SH.A.

Bazuar në Ligjin nr 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë ,Ligjin nr.03/L-087 mbi Ndërmarrjet Publike i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin nr. 04/L-111 dhe Ligjin 05/L-009 dhe Ligjin nr 03/L-212 të Punës ,Bordi i Drejtorëve të KRU “Mitrovica” Sh.A. miratoi këtë :

RREGULLORE PËR SIGURINË DHE SHËNDETIN NË PUNË NË KOMPANINË RAJONALE “MITROVICA” SH.A

Neni 1

Baza Ligjore

Kjo rregullore përmban parimet e përgjithshme për parandalimin e rreziqeve profesionale, eliminimin e faktorëve të rrezikut dhe aksidenteve në punë, si dhe mbrojtjen e ambientit i punës, nëpërmjet informimit, konsultimit dhe trajnimit të punonjësve konform Ligjin nr 04/L-161 për Sigurinë dhe Shëndetin në Punë.

Neni 2

Objekti

Kjo Rregullore ka për objekt përcaktimin e masave, që synojnë garantimin e sigurisë dhe të shëndetit në punë të të punësuarave.

Neni 3

Qëllimi

Rregullorja ka qëllim:

- a) Të garantojë sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksident, informimit, këshillimit, pjesëmarrjes së balancuar, në përputhje me ligjin, trajnimin e të punësuarave e të përfaqësuesve të tyre;
- b) Të përcaktojë udhëzimet e përgjithshme për zbatimin e këtij qëllimi.

Neni 4

Fusha e zbatimit

1. Dispozitat e kësaj Rregullore zbatohen në të gjitha Njësitë e KRU “ MITROVICA “ SH.A , duke përfshirë Fabrikat për trajtimin e ujit ,Stacionet e Pompimit si dhe Pikat e Inkasimit .

2. Nuk do të zbatohen dispozita të caktuara të kësaj Rregullore, kur në dispozitat e tjera ligjore për fushat përkatëse jepen trajtime më të favorshme për mbrojtjen e sigurisë e të shëndetit në punë të punëmarrësve.

3. Kjo Rregullore nuk do të zbatohet, kur veçoritë karakteristike të disa veprimtarive të veçanta të shërbimit publik, si forcat e armatosura, policia e shtetit, ose disa veprimtari për menaxhimin e emergjencave civile, janë në kundërshtim me përcaktimet e kësaj Rregullore. Në këto raste siguria dhe shëndeti në punë duhet të sigurohen sa më shumë të jetë e mundur, në përputhje me kërkesat e kësaj Rregullore.

Neni 5

Përkufizimet

Në këtë Rregullore termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

1. **“Aksident në punë ose për shkak të punës”** është çdo ngjarje e papritur, që shkakton dëmtimin e menjëhershëm trupor, që ndodh gjatë kryerjes së punës apo të një shërbimi lidhur me të, si dhe çdo dëmtim tjetër i shëndetit, që nuk rrjedh nga sëmundje e përgjithshme, por që sjell paaftësi të përkohshme ose të përhershme në punë ose vdekje.

2. **“Dokument i vlerësimit të rrezikut”** është dokumenti, ku përshkruhen karakteristikat e procesit të punës, që përmban identifikimin e vlerësimit të rrezikut për sigurinë e shëndetin në punë dhe përcakton mbrojtjen e duhur.

3. **“Incident i rrezikshëm”** është veprimtaria e identifikueshme, e tillë si shpërthimi, zjarri, aksidenti teknik, çlirimet e rrezikshme në ajër, si rezultat i keqfunksionimit të një veprimtarie ose i një pajisjeje pune dhe sjellja e papërshtatshme e faktorit njerëzor, që nuk shkakton dëme në njerëz, por që mund të kishte pasur pasoja të tilla dhe që ka shkaktuar ose mund të kishte shkaktuar dëmtime materiale .

4. **Punëdhënësi** – personi fizik apo juridik i cili siguron punë për një ose më shumë të punësuar, i paguan pagën të punësuarit/ve për punën ose shërbimet e kryera dhe është përgjegjës për subjektin punues.

5. **I punësuar** - personi fizik i cili kryen punë ose shërbime me pagesë për punëdhënësin dhe ka marrëdhënie punësimi me punëdhënësin

6. **Rrezik** – mundësia që të punësuarit t'i shkaktohet plagë, sëmundje ose probleme shëndetësor të menjëhershme apo të mëvonshme, si rezultat i ekspozimit në ambientin e punës ku paraqiten elemente të dëmshme kimike, fizike dhe biologjike, mjeteve të punës dhe makinerive pa pajisje mbrojtëse dhe të pasigurta për përdorim, mënyrës së gabuar të përdorimit të mjeteve të punës dhe makinerive si dhe mënyrës së gabuar të organizimit të punës

7. **Rrezik i mundshëm dhe serioz** - veprimtari e identifikueshme, që paraqet rrezik, dhe e cila në një periudhë të shkurtër kohore mund të shkaktojë dëme materiale ose në njerëz

8. **Sëmundje profesionale** - çdo sëmundje e shkaktuar nga ekspozimi në elementet e dëmshme dhe të rrezikshme kimike, fizike dhe biologjike në ambientin e punës gjatë ushtrimit të veprimtarisë së punës

9. Masat parandaluese - të gjitha veprimet e ndërmarra dhe të planifikuara në të gjitha proceset e punës në subjektin punues për të evituar dhe minimizuar rreziqeve që shkaktohen nga ushtrimi i veprimtarisë së punës

10. Vendet e punës - përfshijnë të gjitha vendet dhe hapësirat nën mbikëqyrjen direkte dhe indirekte nga punëdhënësit ku të punësuarit duhet të kryejnë aktivitete pune dhe të qëndrojnë gjatë procesit të punës

11. Personi i ngarkuar për sigurinë dhe shëndetin në punë - profesionist i cili është i punësuar te punëdhënësi dhe është i caktuar për të kryer detyra që lidhen me sigurinë dhe shëndetin në punë

12. Persona ose shërbime të specializuara – personat fizikë ose juridikë, jashtë subjekteve punuese të kualifikuar dhe të licencuar, për të kryer veprimtarinë nga siguria dhe shëndeti në punë në pajtim me këtë ligj.

Neni 6

Detyrime të përgjithshme të punëdhënësve

1. Punëdhënësi është përgjegjës për të krijuar kushtet e punës të sigurta dhe të shëndetshme në të gjitha aspektet e punës.
2. Punëdhënësi është i detyruar që të mbulojë të gjitha shpenzimet për kurimin e të punësuarit që ka pësuar lëndim në punë apo sëmundje profesionale, nëse nuk i ka siguruar në ndonjë kompani të sigurimeve të të punësuarit në pikëpamje shëndetësore.
3. Punëdhënësi është i detyruar të bëjë vlerësimin e hollësishëm mbi rreziqet për secilën vend të punës.
4. Punëdhënësi është i detyruar të udhëhiqet nga parimi i trajtimit të barabartë në marrjen e masave të sigurisë dhe shëndetit në punë për të gjithë të punësuarit.
5. Në kuadër të përgjegjësisë së tij, punëdhënësi detyrohet të ndërmarrë masat për siguri dhe shëndet në punë, përfshirë masat për parandalimin e rreziqeve profesionale, sigurimin e informatave, trajnimeve të të punësuarve për punë të sigurt, udhëzimet e duhura për përdorimin dhe mirëmbajtjen e makinerive, instrumenteve, pajisjeve dhe veglave të punës, masat për organizimin dhe mbarëvajtjen e procesit të punës.
6. Punëdhënësi duhet të veprojë në vazhdimësi në përmirësimin e kushteve të punës për të ngritur nivelin e sigurisë dhe shëndetit në punë, duke i ndryshuar dhe plotësuar masat e



ndërmarrja më parë varësisht prej rrethanave të cilat krijohen me ndryshimet e proceseve teknike – teknologjike.

7. Punëdhënësi i përgjigjet të punësuarit për dëmet e shkaktuara nga lëndimi në punë, sëmundjet profesionale ose sëmundjet e lidhura me punën, sipas parimit të përgjegjësisë objektive të së drejtës së detyrimeve.

Neni 7

Masat parandaluese

1. Punëdhënësi ngarkon një ose disa punëmarrës, që të merren me çështjet e mbrojtjes, të sigurisë e shëndetit në punë dhe të parandalimit të rreziqeve profesionale në ndërmarrje/institucion.

2. Në përputhje me pikën 1 të këtij neni:

a) punëmarrësi/punëmarrësit i/e ngarkuar nuk mund të cenohen për shkak të veprimtarisë së tij/tyre, lidhur me mbrojtjen dhe parandalimin e rreziqeve profesionale;

b) punëmarrësit/punëmarrësve i/u jepet koha e nevojshme për të realizuar detyrimet që rrjedhin nga kjo Rregullore.

c) punëmarrësit/punëmarrësve i/u sigurohen nga punëdhënësi mjetet dhe trajnimi i nevojshëm për të realizuar detyrimet që rrjedhin nga ky ligj.

3. Për organizmin e veprimtarive parandaluese dhe mbrojtëse, në përshtatje me madhësinë e ndërmarrjes/institucionit, punëmarrësit dhe personat e shërbimeve të specializuara duhet:

a) të kenë aftësitë dhe kualifikimin e duhur;

b) të disponojnë mjetet dhe pajisjet e duhura dhe profesionale, si dhe aparaturat matëse;

c) të jenë mjaftueshëm në numër për të marrë në ngarkim veprimtaritë për mbrojtjen dhe parandalimin e rreziqeve, ndaj të cilave ekspozohen punëmarrësit, si dhe shpërndarjen e tyre në ndërmarrje/institucion.

4. Personat përgjegjës për sigurinë e shëndetin në punë, të caktuar nga ndërmarrja dhe shërbimet e specializuara si Policia dhe Punonjësit Shëndetësor bashkëpunojnë, kur është e nevojshme, për çështjet e sigurisë e të mbrojtjes së shëndetit në punë.

Neni 8

Ndihma e parë, mbrojtja kundër zjarrit dhe evakuimi i punëmarrësve, rreziqet e rënda dhe të menjëhershme

1. Punëdhënësi:

- a) merr masa paraprake për të organizuar dhënien e ndihmës së parë, mbrojtjen nga zjarri dhe evakuimin në rastet kur ka rrezik për të ndodhur ngjarje;
- b) merr masa për të ulur, sa më shumë të jetë e mundur, kërcënimet për sigurinë dhe shëndetin në punë të punëmarrësve e të personave të tjerë të pranishëm;
- c) organizon dhe siguron evakuimin e shpëtimit e punëmarrësit në rast ngjarjesh ose aksidentesh të papritura, që kërcënojnë sigurinë dhe shëndetin e tyre;
- ç) trajnon personat, që do të kryejnë evakuimin e shpëtimit dhe siguron, me anë të personave të trajnuar, realizimin e evakuimit e të shpëtimit, fikjen e zjarrit dhe dhënien e ndihmës së shpejtë me pajisjet e nevojshme;
- d) harton një plan për evakuimin dhe shpëtimit në situata emergjente, të cilin ia bën të ditur të gjithë punëmarrësve, si dhe kryen ushtrime praktike, të paktën një herë në dy vjet, në përputhje me këtë plan;
- dh) organizon dhe jep ndihmën e shpejtë për punëmarrësit e dëmtuar në punë ose punëmarrësit, që pësojnë sëmundje të papritura, derisa ata të dërgohen në një institucion të kujdesit shëndetësor;
- e) cakton të paktën një punëmarrës të trajnuar, i cili mund të japë ndihmën e shpejtë, të fikë zjarrin ose të kryejë veprime shpëtimi a evakuimi dhe, nëse ka më tepër se 20 persona, që punojnë në të njëjtin mjedis pune, duhet të ketë të paktën dy punëmarrës të trajnuar për ofrimin e këtyre shërbimeve.

2. Punëdhënësi vendos pajisje të nevojshme në dispozicion të punëmarrësve përgjegjës për ndihmën e shpejtë, shpëtimit dhe evakuimin në rast zjarri.

3. Punëdhënësi duhet:

- a) të informojë, sa më shpejt të jetë e mundur, të gjithë punëmarrësit që janë ose mund të jenë të ekspozuar ndaj një rreziku të rëndë dhe të menjëhershëm, për rrezikun e për masat e marra ose që do të merren për mbrojtjen e tyre;

b) të japë udhëzimet e duhura e të marrë masa për t'i lejuar punëmarrësit, në rast rreziku të rëndë, të menjëhershëm dhe të pashmangshëm, të ndalojnë veprimtarinë e tyre dhe të lënë në mënyrë të menjëhershme vendin e punës, duke kaluar në një vend të sigurt;

c) me përjashtim të ndonjë rasti shumë të motivuar, të mos u kërkojë punëmarrësve rifillimin e punës, kur rreziku i rëndë dhe i menjëhershëm vazhdon (është prezent).

4. Punëmarrësi, i cili në rast rreziku të rëndë, të menjëhershëm dhe të pashmangshëm, largohet nga vendi i punës ose zona e rrezikshme, nuk mund të cenohet nga punëdhënësi, por duhet të mbrohet kundrejt çdo pasoje dëmtuese dhe të pajustificuar.

5. Punëdhënësi siguron që çdo punëmarrës, në rast rreziku të rëndë dhe të menjëhershëm për sigurinë e tij vetjake dhe atë të personave të tjerë dhe në rast pamundësie kontakti me superiorin hierarkik përgjegjës, duke u mbështetur në njohuritë e tij e në mjetet teknike që disponon, të mund të marrë masat e duhura për të shmangur pasojat e një rreziku të tillë. Veprimi i tij nuk cenon atë, me përjashtim të rasteve, kur ai ka vepruar me pakujdesi ose ka neglizhuar rëndë.

Neni 9

Këshilli i sigurisë dhe shëndetit në punë

1. Në ndërmarrje ngrihet këshilli i sigurisë dhe shëndetit në punë, i cili ka si mision të kontribuojë në mbrojtjen e shëndetit fizik dhe mendor dhe të sigurisë së punëmarrësve, si dhe në përmirësimin e kushteve të punës.
2. Këshilli është organ partneriteti këshillues me përfaqësues të punëdhënësve dhe të punëmarrësve, të përfaqësuar në mënyrë të barabartë, i cili ka si qëllim këshillimin e rregullt dhe periodik të veprimtarisë së ndërmarrjes, për parandalimin e rreziqeve në punë.
3. Përfaqësuesit e këshillit kanë të drejtë të marrin pjesë dhe të analizojnë problemet për parandalimin e rreziqeve në punë në ndërmarrje.
4. Përbërja dhe rregullat për organizimin dhe funksionimin e këshillit të sigurisë dhe shëndetit në punë përcaktohen nga Ligji për Siguri dhe Shëndet në Punë.
5. Për të punësuarin e ngarkuar, i cili ushtron aktivitetet nga siguria dhe shëndeti në punë, punëdhënësi duhet të sigurojë trajnime dhe mjete të nevojshme për punë.
6. Punëdhënësi, në mungesë të personelit të kualifikuar për të udhëhequr me sigurinë dhe shëndetin në punë, brenda subjektit të tij do të angazhojë persona ose institucione për shërbime profesionale të jashtme.

9.1 Kompetencat e këshillit të sigurisë dhe shëndetit në punë

1. Këshilli i sigurisë dhe shëndetit në punë ka këto kompetenca:

a) merr pjesë në vlerësimin, hartimin dhe vënien në jetë të programeve të parandalimit të rreziqeve në ndërmarrje;

b) nxit nisma për mënyrat dhe procedurat për parandalimin efektiv të rreziqeve, duke i propozuar ndërmarrjes përmirësimin e kushteve dhe mënjanimin e rreziqeve.

2. Punëdhënësi është i detyruar të zbatojë propozimet e bëra nga këshilli i sigurisë dhe shëndetit në punë, duke bashkëpunuar me Institucionet Shtetërore, në rastet kur punëdhënësi angazhon persona apo Institucione për shërbime nga siguria dhe shëndeti në punë, është i detyruar t'i informojë dhe njoftojë ata me procesin e punës, me rreziqet e mundshme, me rrethanat të cilat ndikojnë ose mund të ndikojnë në sigurinë dhe shëndetin e të punësuarve dhe me masat parandaluese që i ka ndërmarrë për të krijuar kushte të sigurt dhe të shëndetshme të punës për të punësuarit.

3. Personat e jashtëm apo institucionet për të ushtruar aktivitetet nga fusha e sigurisë dhe shëndetit në punë duhet të jenë të pajisura me mjetet dhe pajisjet e duhura profesionale të punës si dhe aparaturat matëse adekuate.

Neni 10

Detyrimet e punëdhënësit për caktimin e masave për parandalimin e aksidenteve në punë dhe të sëmundjeve profesionale

1. Punëdhënësi, për caktimin e masave për të parandaluar aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale, është i detyruar që të:

1.1. miratojë fazën e kërkimit, të projektimit dhe hartimit të planit për përdorimin e pajisjeve të punës, në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe ligjeve tjera të aplikueshme, që çojnë në zvogëlimin dhe shmangien e rreziqeve, aksidenteve në punë dhe sëmundjeve profesionale;

1.2. përpilojë një dokument vlerësimi dhe parandalimi të rrezikut që përmban masat me karakter teknik, organizativ, higjieniko-sanitar, të cilat do të zbatohen sipas kushteve specifike të vendeve të punës për veprimtarinë përkatëse;

1.3. përcaktojë cilësitë dhe përgjegjësitë e të punësuarit në fushën e sigurisë dhe të shëndetit në punë, në përshkrimet e punës, sipas pozicionit përkatës të punës.

Neni 11

Detyrimet e punëdhënësit për zbatimin e masave për parandalimin e aksidenteve në punë dhe të sëmundjeve profesionale

1. Për garantimin e zbatimit të masave për të parandaluar aksidentet në punë dhe sëmundjet profesionale, punëdhënësi është i detyruar që të:
 - 1.1. mbikëqyrë punën dhe cilësinë e kryerjes së shërbimeve të personave ose të shërbimeve të jashtme të kontraktuara prej tij për sigurinë dhe shëndetin në punë;
 - 1.2. ndër marrë masat për të siguruar materialet e nevojshme për informimin dhe trajnimin e të punësuarve dhe të vendosë shenja adekuate për siguri, postera, fletushka, filma, filmime të lidhura me sigurinë dhe shëndetin në punë;
 - 1.3. sigurojë informimin e çdo të punësuarit përpara fillimit të punës për rreziqet ndaj të cilave ai mund të ekspozohet në vendin e tij/saj të punës, si dhe për masat e nevojshme parandaluese dhe mbrojtëse;
 - 1.4. sigurojë që të punësuarit të jenë të pajisur me kualifikimet përkatëse profesionale;
 - 1.5. sigurojë funksionimin e vazhdueshëm dhe të duhur të sistemeve dhe mjeteve mbrojtëse, mjeteve të matjes dhe të kontrollit, si dhe të pajisjeve të diktimit, mbajtjes nën kontroll dhe neutralizimit të substancave të rrezikshme që lirohen gjatë zhvillimit të proceseve teknologjike;
 - 1.6. marrë në punë të punësuarin në bazë të ekzaminimit mjekësor të tij, në varësi të vendit të punës;
 - 1.7. lejojë përfaqësuesin e të punësuarve, me kërkesën e këtij të fundit, të marrë pjesë gjatë vizitës së inspektimit, si dhe në rastet e hetimit të ngjarjeve;
 - 1.8. lejojë të punësuarin të marrë pjesë në inspektimin dhe hetimin e ngjarjeve, me kërkesën e inspektorit të punës;
 - 1.9. ruajë të gjitha provat në vendngjarje ku ka ndodh aksidenti me pasojë vdekjeje, qoftë ky dhe kolektiv, me përjashtim të rasteve kur ruajtja e atyre provave në vendngjarje mund të shkaktojë një tjetër aksident;

- 1.10. sigurojë numër të mjaftueshëm të aparateve për fikjen e zjarrit dhe të njëjtat të jenë me mbushje adekuate sipas llojit të shkaktarit të zjarrit;
- 1.11. mbajë në gjendje të rregullt dhe t'i rimbushë në afate të caktuara të cilat shënohen në tiketën e vendosur në aparat;
- 1.12. vendosë në vende të përshtatshme aparatet për fikjen e zjarrit;
- 1.13. instalojë hidrantë në subjektet punuese ku ka rrezik të shtuar për shpërthimin e zjarrit dhe ku konsiderohet që aparatet për fikjen e zjarrit nuk janë të mjaftueshme;
- 1.14. vendosë hidrantet në vende të dukshme, të përshtatshme dhe duhet të jenë në gjendje të rregullt për përdorim në çdo kohë;
- 1.15. të shënojë qartë ndalimin e pirjes së duhanit në vendet e punës dhe në vende publike;
- 1.16. pajisë të punësuarit, në mënyrë të detyrueshme, me pajisje mbrojtëse individuale, të sigurojë mirëmbajtjen e tyre dhe të respektojë afatet e skadimit të përdorimit të tyre.

Neni 12

Identifikimi , Njoftimi ,Regjistrimi dhe Raportimi i Ngjarjeve dhe Aksidenteve në Punë

Çdo ngjarje i komunikohet menjëherë punëdhënësit nga personi përgjegjës në vendin e punës ose nga çdo person tjetër, që ka dijeni për ndodhjen e saj.

1. Punëdhënësi detyrohet të njoftojë menjëherë për ngjarjet Inspektoratin Shtetëror të Punës dhe organet e prokurorisë, në rastet e aksidenteve fatale ose në të gjitha rastet e ngjarjeve të tjera, kur mendohet se ngjarja përbën vepër penale , si dhe institucionet e tjera, sipas përcaktimeve të rregulluara me ligj të veçantë.
2. Mjeku i shërbimit mjekësor në punë, mjeku i familjes apo institucionet shëndetësore të tjera publike ose private deklarojnë sëmundjen profesionale të zbuluar gjatë ekzaminimeve mjekësore.

12.2 Hetimi i ngjarjes është i detyrueshëm dhe kryhet nga:

- a) punëdhënësi, kur ngjarjet kanë çuar në paaftësi të përkohshme në punë;
- b) drejtoritë rajonale/autoritetet vendore të inspektimit në punë, kur ngjarjet çojnë në paaftësi të dukshme për punë, vdekje, aksidente kolektive, incidente të rrezikshme



c) autoritetet vendore të shëndetit publik, në rast të dyshimit për sëmundjet profesionale dhe të sëmundjeve që lidhen me profesionin.

2. Rezultati i hetimit të një ngjarjeje duhet regjistrohet në një procesverbal.

12.3 Vlerësimi i aksidentit në punë

Aksidenti vlerësohet se ka ndodhur në punë ose për shkak të punës, kur punëmarrësi dëmtohet gjatë:

a) kryerjes së punës, sipas përshkrimit të saj;

b) kryerjes së një pune tjetër, pa urdhër të punëdhënësit, por për arsye madhore, në interes të punës;

c) kryerjes së një pune tjetër me porosi të punëdhënësit;

ç) kohës së pushimit në vendin e përcaktuar nga punëdhënësi, ose për vënien në rregull të makinerive, veglave të punës, veshmbathjeve, para ose pas mbarimit të punës

12.4 Regjistrimi i aksidentit në punë

1. Regjistrimi i aksidentit në punë bëhet në bazë të një procesverbali.

2. Aksidenti në punë, i regjistruar nga Këshilli i Sigurisë dhe Shëndetit në Punë sipas Procesverbalit i Raportohet Administratës dhe Menaxhmentit të Kompanisë

3. Menaxhmenti pas vlerësimit të këtij Procesverbali, nxjerr vendim ku pranohet / pranohet pjesërisht /ose refuzohet ,përveç atyre rasteve ku rrethanat e ngjarjes nuk ka nevojë të provohet por duhet pranuar me urgjencë (Rastet me fatalitet).

Neni 13

Përdorimi i mjeteve të punës dhe pajisjeve mbrojtëse individuale gjatë procesit të punës

1. Punëdhënësi është i obliguar që mjetet e punës t'i mbajë në gjendje të rregullt, ta kontrollojë rregullsinë dhe sigurinë e tyre me kontrolla të herëpashershme në afate të përcaktuara me aktin që e miraton ai, përkatësisht me udhëzimin e prodhuesit, dispozitat dhe standardet teknike.

2. Nëse me udhëzimin e prodhuesit nuk janë parashikuar afate të tjera, punëdhënësi është i obliguar që mjetet e punës t'i kontrollojë, provojë dhe testojë:

2.1. para përdorimit të parë,

2.2. pas rekonstruktimit, pas avarisë dhe

2.3. pas zhvendosjes nga njëri vend në vendin tjetër.

3. Punëdhënësi duhet të sigurojë që mjetet e punës dhe pajisjet individuale mbrojtëse, të jenë në gjendje të mirë dhe të rregullt në çdo kohë.

4. Punëdhënësi nuk mund të përdorë apo të vërë në punë, mjetet dhe pajisjet për mbrojtje individuale, në qoftë se ato nuk i përgjigjen standardeve teknike në përputhje me rregullat e sigurisë dhe shëndetit në punë.

Neni 14

Vlerësimi i rrezikshmërisë në vendet e punës

1. Punëdhënësi është i detyruar të bëjë vlerësimin e rrezikshmërisë në vendet e punës, me qëllim të parandalimit të rrezikut, përfshirë dhe ekspozimin e të punësuarve nga elementet e dëmshme dhe të rrezikshme për shëndetin dhe sigurinë në punë gjatë procesit të punës.

2. Vlerësimi i rrezikshmërisë në vendet e punës bëhet nga profesionistë të fushave përkatëse brenda subjektit punues të caktuar nga punëdhënësi, përkatësisht nga shërbimet e jashtme ose personat e kontraktuar nga punëdhënësi.

3. Punëdhënësi, pas procesit të vlerësimit të rrezikshmërisë, është i detyruar të hartojë dokumentin e vlerësimit të rrezikut dhe të ndërmarrë masat mbrojtëse të domosdoshme për sigurinë dhe shëndetin në punë të të punësuarve.

4. Mënyra e përgatitjes së dokumentit për vlerësimin e rrezikut, përmbajtja e tij si dhe të dhënat mbi të cilat duhet të bazohet vlerësimi i rrezikut, rregullohen me akt nënligjor, të nxjerrë nga Ministria, në pajtim me ministrinë kompetente për çështjet e shëndetësisë.

5. Punëdhënësi është i detyruar të mbajë evidencën për lëndime në punë, sëmundjet profesionale dhe të pajisë të lënduarin me fletëlëndim në vend të punës.

6. Punëdhënësi është i detyruar që në bashkëpunim me autoritetet përgjegjëse për siguri dhe shëndet në punë, të hartojë raporte mbi aksidentet dhe sëmundjet profesionale në subjektin e tij punues.

Neni 15

Informimi i të punësuarve



1. Punëdhënësi merr masa adekuate që të punësuarit apo përfaqësuesit e tyre të marrin të gjitha informatat e nevojshme lidhur me:

1.1. çdo rrezik që mund të paraqitet në vendet e punës, masat mbrojtëse dhe parandaluese si dhe aktivitetet që i ndërmerren nga ana e tij për eliminimin e këtyre rreziqeve;

1.2. informimin e të punësuarve dhe përfaqësuesve të tyre për ndihmën e parë, masat në rast zjarri, evakuimin, si dhe përgjegjësitë e veçanta të secilit për marrjen e këtyre masave;

1.3. vlerësimin e rrezikut, si dhe masat e ndërmarra për të siguruar shëndetin dhe mbrojtjen në punë për të punësuarit, fëmijët, të rinjtë, gratë shtatzëna, gratë me fëmijë në gji dhe personat me aftësi të kufizuara.

2. Punëdhënësi do të ndërmarrë masa adekuate për informimin e punëdhënësit të kontraktuar, të angazhuar me punë në subjektin e tij ekonomik lidhur me nën-paragrafët 1.1., 1.2. dhe 1.3. të paragrafit 1. të këtij neni.

3. Punëdhënësi vë në dispozicion të të punësuarve udhëzimet e hollësishme, në zbatimin e 10 dokumentit të vlerësimit dhe parandalimit të rrezikut, për çdo vend pune, i dokumentuar nëpërmjet një procesverbali.

Neni 16

Trajnimi i të punësuarve

1. Punëdhënësi përkujdeset që secili i punësuar të trajnohet nga siguria dhe shëndeti në punë, për vendin e tij të punës si:

1.1. para ose pas themelimit të marrëdhënies së punës;

1.2. në rast të transferimit apo ndërrimit të vendit të punës;

1.3. në rast të paraqitjes së pajisjeve të reja apo ndërrimit të pajisjeve të punës;

1.4. në rast të përdorimit të teknologjisë së re;

1.5. kohë pas kohe nëse është e domosdoshme.

2. Punëdhënësi përkujdeset që të punësuarit e subjektit të kontraktuar të marrin udhëzimet adekuate për sigurinë dhe shëndetin në punë gjatë aktivitetit të tyre në subjektin e tij.

3. Përfaqësuesit e punëtorëve me rol specifik për sigurinë dhe shëndetin në punë do të kenë të drejtë të vijnë trajnime adekuate.

4. Trajnimi i referuar në paragrafin 1. të këtij neni organizohet gjatë orarit të punës.

Neni 17

Detyrimet e të punësuarit

Punëmarrësi duhet që, në përputhje me formimin e tij, me instruksionet e dhëna nga punëdhënësi dhe me manuallet e udhëzimet dhe rregulloret teknike:

- a) të përdorë me korrektësi makineritë, aparaturat, veglat, substancat e rrezikshme, pajisjet e transportit dhe mjetet e tjera;
- b) të përdorë me korrektësi pajisjet mbrojtëse individuale, të vëna në dispozicion të tyre dhe, pas përdorimit, rikthimin e tyre në vendin që është planifikuar ruajtja e tyre e sigurt;
- c) të mos nxjerrë jashtë shërbimit, të ndryshojë ose të zhvendosë mekanizmat e sigurisë të montuara në makineri, të aparaturave, veglave, impianteve dhe ndërtesave dhe t'i përdorë si duhet këta mekanizma;
- d) të njoftojë, në mënyrë të menjëhershme, punëdhënësin, punëmarrësin e ngarkuar për çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë dhe përfaqësuesit e punëmarrësve, për çdo situatë pune, për të cilën kanë një motiv të arsyeshëm për ta vlerësuar si rast që paraqet një rrezik të rëndë të menjëhershëm për sigurinë dhe shëndetin, si dhe për çdo defekt të konstatuar në sistemin e mbrojtjes;
- e) të bashkëpunojë me punëdhënësin, punëmarrësin e ngarkuar për çështjet e sigurisë dhe shëndetit në punë dhe përfaqësuesit e punëmarrësve;
- f) deri në kryerjen e të gjitha detyrave ose të kërkesave të përcaktuara nga inspektori i punës, me qëllim që të mbrohet siguria dhe shëndeti i punëmarrësve në punë;
- g) derisa të jetë e nevojshme për t'i lejuar punëdhënësit të sigurojë që mjedisi dhe kushtet e punës të jenë të sigurta dhe pa rrezik për sigurinë dhe shëndetin, brenda fushës së tyre të veprimtarisë.

Neni 18

Kontrollimet mjekësore të të punësuarve

1. Punëdhënësi është i detyruar t'iu sigurojë të punësuarve kontrollime mjekësore në institucionet shëndetësore të licencuara për shërbime nga mjekësia e punës

2. Punëdhënësi është i detyruar t'i dërgojë në kontrollim mjekësor të gjithë të punësuarit së paku një herë në tre (3) vite.

Neni 19

Plani i Reagimit Emergjent

Ndërmarrja është përgjegjëse për organizimin e mbrojtje nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë tjera , zvogëlimi i numrit të fatkeqësive në pajtim me Ligjin për Mbrojtje nga fatkeqësitë natyre dhe fatkeqësitë tjera ,që kanë për subjekt ofrimin e mbrojtjes nga fatkeqësitë dhe fatkeqësitë tjera .

Sistemi i mbrojtjes përmban planifikimin ,organizimin ,menaxhimin ,zbatimin ,mbikëqyrjen ,koordinimin dhe financimin e aktiviteteve për mbrojtje nga fatkeqësitë natyre .

Ndërmarrja duhet të sigurojë kushte dhe mundësi të nevojshme për realizimin e mbrojtjes personale dhe reciproke si dhe implementimin e masave mbrojtëse të përcaktuara me Ligj , duke bashkëpunuar me shërbimet publike për mbrojtje dhe shpëtim në nivel qendror dhe komunal.

Në rast të fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësi tjera ,shpëtimi dhe mbrojtja e punëtorëve ka përparësi ndaj çdo aktiviteti të Ndërmarrjes.

19.1 Përgjegjësia e punëtorëve

Çdo punonjës ka për detyrë që personit të cilit i kanoset rreziku për jetë apo shëndet ,t'i ndihmojë nëse në atë mënyrë nuk e rrezikon jetën e vet .

Punonjësit e Ndërmarrjes janë të detyruar , që në mënyrë dhe kushte të përcaktuara me Ligj , me mjetet e veta transportuese , teknike dhe mjetet tjera , si dhe me punën e vet të marrin pjesë për tejkalimin e situatës emergjente nga rreziqet prej fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësi tjera , për shpëtimin e njerëzve dhe pasurisë së rrezikuar

Të punësuarit në Ndërmarrje janë të detyruar të mobilizohen dhe të zbatojnë masat për parandalimin dhe mbrojtjen nga fatkeqësive natyrore dhe fatkeqësitë tjera .

Lëndimi ose sëmundja ,e cila shfaqet gjatë kryerjes së detyrave ,aftësimin dhe mbrojtjes apo shpëtimin trajtohet lëndim në punë ose sëmundje profesionale dhe punëtori gëzon të drejtat sipas dispozitave ligjore në fuqi .

19.2 Përmbajtja e planit të reagimit emergjent

Plani emergjent përmban

- a) Organizimin dhe mënyrën e zbatimit të mbrojtës personale dhe reciproke të punëtorëve

- b) Mënyrën e realizimit të bashkëpunimit me institucionet lokale dhe strukturat e mbrojtjes ,shpëtimit dhe ndihmës ;
- c) Mënyrën e zbatimit te detyrave për evakuim ,mbrojtje dhe shpëtim
- d) Mënyrën e njoftimit dhe alarmimit;
- e) Pasqyrën e strukturave të mbrojtjes dhe shpëtimit me numra të telefonit (Zjarrfikëset, Policia ,Emergjencia etj)
- f) Skicat me burimet e rreziqeve

Ndërmarrja është e obliguar që për secilin objekt veç e veç si minimum të sigurojë kutitë e ndihmës së parë në varësi prej numrit të punëtorëve .

Neni 20 **Hyrja në fuqi**

Kjo Rregullore hyn ne fuqi me miratimin e Bordit të Drejtorëve të KRU Mitrovica Sh.A. dhe regjistrohet në Protokoll në Administratën e Ndërmarrjes në fjalë .

Kryesuese e Bordit të Drejtorëve në KRU,, MITROVICA” Sh.A.

Kumarije Kelmendi Aliu

